

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Ferit Omani, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M.H., nga fshati ..., Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale ndryshimi i njehsorit të shërbimeve, nga neni 323 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1174-5/14, të datës 5 prill 2018, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.816/2014, të datës 21 shkurt 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 27 korrik 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.816/2014 i datës 21 shkurt 2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin e lartcekur, të akuzuarin M.H., konform nenit 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP) e ka liruar nga akuza, për shkak të veprës penale ndryshimi i njehsorit të shërbimeve, nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK.

Përfaqësuesi juridik i KEDS në Ferizaj, Skender Musa, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale është vendosur që të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokuroria Themelore në Ferizaj, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ta aprovojë ankesën si të

bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që ndaj të akuzuarit të merr aktgjykim dënues me të cilin aktgjykim të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit M.H., avokati E.Sh., duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetojë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.521/2018, të datës 23 maj 2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe kjo çështje penale t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosije.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPP, konstatoj se:

- ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje së ligjit penal, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës konform nenit 394 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe gjeti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, theksohet se gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të provave gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka konstatuar se në shtëpinë e të akuzuarit M.H. në të cilin ka lokaln-vullkanizer është hequr njehsori elektrik me numër 41546706 dhe se i akuzuari më datën 25 mars 2014 nuk ka qenë në posedim, përdorim dhe shfrytëzim të objektit ku ishte vendosur njehsori elektrik. Gjykata e shkallës së parë më rastin e vlerësimit të provave ka bërë shkelje të nenit 386 paragrafi 1 të KPP për shkak se gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që gjykata në aktgjykimin e ankimuar në një rën anë thekson se është hequr njehsori elektrik me numrin e lartcekur pa e sqaruar nëse vepra penale është konsumuar, ndërsa kur i referohet dëshmisë së dëshmitarëve konstaton se njehsori elektrik është ndërruar nga punëtorët e KEDS-it, konkretisht nga I.Sh. i cili ja ka vendosur njehsorin e ri elektrik digjital të cilin e ka bllobuar në mënyrë të rregullt, ndërsa njehsorin e vjetër analog e ka dërguar dhe dorëzuar në zyrat e KEDS-it, mirëpo për këtë fare nuk ka përpiluar procesverbal, ashtu siç përcaktohet në dispozita ligjore. Nëse gjykata e shkallës së parë e ka liruar të akuzuarin M.H. për shkak se ka konstatuar se ndërrimi i njehsorit elektrik është bërë në mënyrë të rregullt nga punëtori i KEDS-it I.Sh. atëherë gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarit të lartcekur pasi që nuk ka dëshmi se njehsorin e lartcekur ta ketë dorëzuar në zyrat e KEDS-it. Nga dëshmia e dëshmitarit Q.T. por edhe nga provat tjera materiale është vërtetuar se në mënyrë të

kundërligjshme është ndërruar njehsori elektrik me numër 41546706 dhe është vendosur njehsori elektrik me numër 73447918. Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike kur ka konstatuar se i akuzuari nuk ka qenë në posedim, përdorim dhe shfrytëzim të objektit-vullkanizerit ku ishte vendosur njehsori elektrik kur kihet parasysh fakti se i akuzuari është me vendbanim në fshatin ... ku është objekti-vullkanizeri dhe nuk është vërtetuar nëse garazha gjendet në të njëjtin objekt ku i pandehuri ka edhe shtëpinë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të Prokurorisë Themelore në Ferizaj janë të pabazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike. Një gjendje të tillë faktike, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar pas administrimit të një mori provave gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë drejtim gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave që janë administruar nga gjykata e shkallës së parë, vlerësimi i të cilave është bërë një nga një dhe duke i ndërlidhur në mënyrë reciproke njëra me tjetrën. Provat mbi bazën e të cilave është vërtetuar gjendja faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë: pjesërisht nga mbrojtja e vetë të akuzuarit, deklaramentet të dëshmitarëve I.Sh., Xh.H., G.S., E.Sh. dhe Q.T., si dhe nga provat materiale, siç janë: procesverbali numër 1215413 i datës 25 mars 2014, fatura e datës 4 tetor 2014, rrjedha e energjisë elektrike në emër të konsumatorit M.H., procesverbalit të ndërrimit dhe heqjes së njehsorit elektrik numër 026334 të datës 14 janar 2014 dhe kontratës mbi qiranë të datave 6 gusht 2012 dhe 5 maj 2016 të lidhura në një rën anë nga M.H. i qiradhënës dhe nga ana tjetër nga Xh.H. si qiramarrës. Nga të gjitha këto prova të cilat janë administruar dhe vlerësuar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë drejtë kishte vepruar kur të akuzuarin M.H. e kishte liruar nga akuza, ngase nuk është provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Edhe Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se nga provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari M.H., ta ketë ndërruar njehsorin elektrik me numër 4156706 dhe në vend të tij pa autorizim të furnizuesit të ketë vendosur njehsorin elektrik me numër 478181, siç pretendohet në aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj. Nga provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konkluduar se njehsorin elektrik e ka ndërruar zyrtari i KEDS-it, z.I.Sh., në një rën anë, kurse në anën tjetër, lokalin për të cilën bëhet fjalë-vullkanizerin, në kohën kur dyshohet se është kryer vepra penale e ka patur në posedim dhe shfrytëzim qiramarrësi Xh.H.. Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe se nga provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se jo çdo dyshim është i mjaftueshëm për t'u shpallur fajtor i akuzuari, por duhet që fajësia e të akuzuarit të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë, duke ju referuar provave të besueshme, kredibile dhe të marra në mënyrë të ligjshme. Andaj, duke u bazuar në të gjitha këto që u cekën më

lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës vendosi që ta refuzojë si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.514/2018, Më datën 27 korrik 2018

Bashkëpunëtore profesionale,
Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala
Ferit Osmani

Kryetari i kolegjit,
Gani Zabeli